

# UNË BËJ NDRYSHIM



# PËR QYTETARËT

## NË DEMOKRACI, NE UDHËHEQIM

ENDRIT (15), MARIGONA (15), ARJETA (15), LEONTINA (14), ADRIATIK (14), ZYMER (15), BRAHIM (14)

DEMOKRACIA 



**Artani është një djalosh i cili i ka humbur të dy këmbët gjatë luftës së fundit në vendin tonë. Mësojeni çfarë bën ai tani, pas aksidentit që ka pësuar**

Në artikullin tonë do të flasim kryesisht për Artanin. Përmes këtij personazhi fiktiv, do të përpiqemi t'u tregojmë për rëndësinë e demokracisë në jetën e të gjithë neve si qytetarë.

Artani tani është 24 vjeçar. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, ai ka humbur të dyja këmbët në një aksident. Ndonëse ka përjetuar këtë aksident të tmerrshëm, kjo gjë asnjëherë nuk e ka ndaluar atë që t'i arrijë qëllimet e veta. Artani është plot jetë dhe asnjëherë nuk është dorëzuar. Ai jeton jetën e tij çdo ditë deri në maksimum. Artani ynë e di se ai jeton në demokraci. Kjo nënkupton se ai është plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat që i ka. Kjo është arsyeja pse ai ka themeluar edhe një organizatë jo qeveritare. Përmes kësaj organizate, ai përpiqet ta ngrisë vetëdijen e qytetarëve për demokracinë dhe të drejtat që ne si qytetarë i gëzojmë. Ai shpesh përdor shprehjen: „Jetojmë në demokraci. Jemi të barabartë, e pa asnjë dallim“. Kurse, ne pajtohemi plotësisht me këtë shprehje.

Artani është person i cili ka nevojë për kujdes të veçantë. Por, sa duhet ta pengoj kjo atë që të ketë një karrierë të suksesshme dhe të jetoj në paqe, liri e të jetë i barabartë me të gjithë? Kjo nuk e pengon aspak, për shkak se demokracia nuk njih dallime fizike,

racore, fetare apo kombëtare. Në demokraci jemi të gjithë të barabartë. Këtë gjë, Artani e di më së miri. Prandaj, ai shfrytëzon të drejtat e tij në demokraci. Barazia është vetëm një nga elementet e demokracisë. Elementet e tjera janë: liria, toleranca, solidariteti, respekti, paqja, etj. Këto elemente përbëjnë bërthamën e demokracisë sonë.

Në thelb, demokracia është udhëheqje e popullit. Kjo do të thotë se ne qytetarët udhëheqim në demokraci, përmes votave tona.


Për herë të parë kjo formë e qeverisjes është paraqitur në Athinë, në vitin 507 p.e.s. Pa dyshim se edhe fjala demokraci rrjedh pikërisht nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull, si dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Asnjëherë nuk duhet t'i humbasim shpresat për një të ardhme akoma edhe më të mirë. Ne jetojmë në demokraci dhe mrekullitë me të vërtetë mund të ndodhin në këtë formë të qeverisjes.



Duke shkruar artikullin për demokracinë

# TË DREJTAT TONA MBROHEN ME LIGJ

GENTRIT (15), LAVDIM (16), EDONIS (14), DONIKA (15), ANISA (14), FLORENT (14), RREZARTA (13),  
ATDHE (14)



**Ne mësuam shumë gjëra rreth Kuvendit. A dëshironi edhe ju të mësoni rreth këtij institucioni shumë të rëndësishëm? Në këtë artikull kemi shkruar pikërisht për rolin e Kuvendit në jetën tonë. Ju ftojmë ta lexoni**

Në demokraci, çdo person ka të drejtën e lirisë dhe të shprehjes së mendimit. Ne si fëmijë, kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës, të drejtën e strehimit, të drejtën e familjes, etj. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj. Ndërsa, vendimet për ligje merren në Kuvendin e Kosovës.


Edhe pse jemi fëmijë, ne patëm rastin sot që të mendonim se çfarë projektligji do të propozonim ne tek deputetët e Kuvendit, po të ishim mbi moshën 18 vjeçare. Ligjet të cilat janë miratuar në Kuvend duhet t'i respektojmë, por ne si pjesë e popullit mendojmë se disa prej tyre mund të ndryshohen, apo dhe të miratohen ligje të reja.

Një ndër projektligjet që do të donim të miratohej është edhe projektligji i cili shkollimin e mesëm të lartë do ta obligonte me ligj. Deri më tani, i obligueshëm është shkollimi fillor dhe ai i mesëm i ulët. Por, po të obligohej edhe shkollimi i mesëm i lartë, kjo do të ndihmonte në përmirësimin e kushteve të shoqërisë sonë, në mënyrë që të gjithë të gëzojmë një jetë sa më të mirë.

Më pas, një ligj tjetër që do të donim të miratohej në Kuvend është ligji për strehimin e qenve endacakë. Me këtë ligj do të mbroheshin të drejtat e kafshëve, si dhe

nuk do të rrezikohet jeta dhe shëndeti i qytetarëve. Ne mendojmë se demokracia duhet të jetë e pranishme në të gjithë botën, sepse me këtë do të sigurohej drejtësi, liri, barazi dhe shumë të drejta të tjera. Të drejtat e tilla ndikojnë në qeverisjen më të mirë të një vendi.

Duke qenë e ardhmja e vendit, ne duhet të përkushtohemi shumë në mësim dhe të jemi nxënës të përgjegjshëm. Kështu do ta ndriçojmë vendin tonë.




Grupi „ Luanët dhe Luaneshat“

## DREJTËSIA DHE BARAZIA NË ZGJEDHJE

PLATOR (15), AGNESA (14), XHEVAHIRE (15), PËRPARIM (14), ALBIJON (15)

### Çka nënkuptojmë me drejtësi dhe barazi në zgjedhje?

Zgjedhjet janë zemra e demokracisë. Përmes tyre, ne kemi mundësi të shprehemi lirshëm duke zgjedhur kështu personat të cilët ne dëshirojmë dhe për të cilët besojmë se do të na përfaqësojnë ashtu siç duhet. Kjo i bie se ata duhet t'i paraqesin dhe diskutojnë kërkesat tona. E nëse duam t'i përgjigjemi pyetjes së parashtruar më lart, ne do t'iu tregojmë se në procesin e votimit të gjithë jemi të barabartë. Asnjë votë nuk ka peshë më të madhe se vota tjetër. Secila prej tyre ka vlerën e barabartë. Po ashtu, vlen të theksohet se kur arrijmë moshën për votim, askush nuk duhet të na detyrojë për të dhënë votën tonë. Të gjithë duhet të vendosim lirshëm se kujt do t'ia japim atë.



### Pse është përcaktuar moshja 18 vjeçare për të votuar?

Miq të dashur, ju e dini se moshja kur fillon pjekuria mentale parashihet moshja 18 vjeçare. Kjo moshë karakterizohet me marrje të vendimeve të mençura, njohuri për të zgjedhur më të mirin/en dhe liri për të vendosur vetë për çka duam nga jeta jonë. Pikërisht në këtë moshë, është paraparë me ligj e drejta për të votuar dhe qytetarëve me këtë iu takon përgjegjësia për të marrë vendimet e duhura. Pas kësaj moshe, mendohet se ne do të jemi të gatshëm të marrim vendime të mira për jetën tonë, duke mos u ndikuar nga personat e tjerë dhe duke mos lënë hapësirë për manipulime nga të tjerët. Në çdo proces të votimit, ti je ai/ajo i/e cili/a vendos vetë!

### Cilat janë llojet e zgjedhjeve në Kosovë?

Shteti ynë Kosova organizon dy lloje të zgjedhjeve, të cilat janë të njohura për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Këto janë: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, populli zgjedh kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Kurse në zgjedhjet qendrore, populli zgjedh deputetët të cilët janë të njohur si përfaqësues të popullit. Nëse kemi çështje që janë shqetësuese për komunën tonë, ne i adresojmë ato tek kryetari i Komunës sonë. E nëse kemi çështje shqetësuese në nivel qendror, këtë e paraqesim tek deputetët e zgjedhur. Kjo do të thotë se ne kemi mjaft mundësi për t'ia adresuar problemet tona. E krejt kjo ndodh falë procesit zgjedhor dhe sistemit më të mirë të qeverisjes, demokracisë.



# QYTETARË TË PËRGJEGJSHËM DHE SHUMË AKTIV

VALON (14), ALBIN (14), SHKURTA (14)

A e keni pyetur ndonjëherë veten tuaj se kush jeni ju dhe cili është roli juaj në vendin ku jetoni? A keni menduar ndonjëherë se si mund të jepni kontributin tuaj? Për këto dhe disa fakte të tjera, vazhdoni të lexoni këtë artikull të shkruar me shumë kujdes nga ne

Njeriu për nga përkufizimi është qenie sociale. Kjo do të thotë se ne duhet t'i mbajmë dhe t'i ruajmë raportet me personat e tjerë. Në këtë term përfshihet edhe rëndësia që mund të kemi tek të tjerët. Këtë mund ta arrijmë përmes ndihmës që mund ta ofrojmë ne, punës vullnetare që mund ta bëjmë, respektimit të vlerave të demokracisë, marrjes së iniciativave të ndryshme pozitive për vendin, si dhe përmes reagimit ndaj pakënaqësive që mund të na paraqiten gjatë jetës sonë. Këto veprime hyjnë në kuadër të konceptit „qytetari aktive“, e cila ka të bëjë me angazhimin e qytetarëve në komunitet, si dhe dëshirën dhe vullnetin e tyre për të ndihmuar dhe bashkëpunuar me të tjerët.



Ne mësojmë se si të jemi aktiv



Qytetarët aktiv respektojnë kurdo dhe ngado ligjet



Ata e mbajnë edhe ambientin ku jetojnë pastër



I ndihmojnë të tjerët, pa asnjë lloj dallimi



Si dhe, ata respektojnë lirinë dhe individualitetin e secilit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Qyqavicës“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1 & IX-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Qirez, Skënderaj